

# BULETIN INFORMATIV

Janar - Dhjetor 2008

**KOMISIONI PËR SHËNDETËSI, PUNË DHE  
MIRËQENIE SOCIALE**



Kuvendi i Republikës  
së Kosovës



Janar - Dhjetor 2008



## *Fjala hyrëse nga Kryetari i Komisionit*



**K**omisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional, është themeluar në shkurt të vitit 2008 dhe ka të përcaktuar fushëveprimin dhe objektivat e tij. Fushat që i mbulon Komisioni janë të gjëra dhe kërkojnë përkushtim të madh, e ato janë: shëndetësia, punësimi dhe çështjet sociale.

*Kjo është legjislatura e tretë që funksionon ky Komision kështu që, është krijuar një vazhdimësi në punën e tij me orientim dhe objektiva të qarta. Në përbërjen e Komisionit ka deputetë nga përbërja e kaluar dhe deputetë të rinjë.*

*Anëtarët e Komisionit përfaqësojnë grupet parlamentare të Kuvendit, të cilët janë të përkushtuar dhe shumë profesional në punën e tyre. Në Komision mbizotëron një frymë kolegjiale dhe për çështje të rëndësishme përmbajtësore ka konsensus në marrjen e vendimeve.*

*Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka arritur me sukses ta përmbyll vitin 2008, duke shqyrtuar një numër të projektligjeve të rëndësishme, që rregullojnë fusha të caktuara në shoqëri. Ndër aktivitetet tjera të Komisionit kanë qenë: organizimi i dëgjimeve publike, monitorimi i zbatimit të ligjit, vizitat nëpër institucione shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale, zhvillimi i debateve në Komision për gjendjen e shëndetësisë, raportimi para Komisionit i Ministrisë të Shëndetësisë dhe përfaqësuesve të institucioneve tjera shëndetësore dhe sociale.*

*Gjatë vitit 2008, Komisioni ka punuar në Projektligjin e Punës, në të cilin është punuar shumë, mirëpo, ky projektligj është tërhequr me kërkesë të Qeverisë dhe kjo mbetet njëra nga sfidat e Komisionit për vitin 2009. Një sfidë tjetër e paraparë nga Komisioni, për vitin 2009, do të jetë shqyrtimi i Projektligjit për Sigurimet Shëndetësore. Ky projektligj është shumë i nevojshëm për qytetarët dhe shëndetësinë në përgjithësi. Për këtë qëllim, Komisioni ka planifikuar të realizoj ndonjë vizitë jashtë vendit, me qëllim të marrjes së përvojave në rregullimin e kësaj fushe. Gjithashtu, Komisioni parasheh të angazhoj ndonjë ekspert që do të ofroj ekspertizën e tij, gjatë procesit të amendimit të projektligjit. Komisioni do të bashkëpunoj ngushtë me të gjitha organizatat vendore e ndërkombëtare (USAID, NDI, OSCE, etj.), me qëllim të arritjes së objektivave të parashtuara para vetes.*

**Sadik Idriz**

*Kryetar i Komisionit*



## *Fushëveprimtaria e Komisionit*

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale është njëri nga komisionet funksionale në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili ka të përcaktuara kornizat e fushave brenda të cilave zhvillon veprimtarinë e tij. Në kuadër të fushëveprimit të tij, Komisioni angazhohet në: përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave për zhvillimin dhe funksionimin sa më efikas të shëndetësisë dhe çështjeve sociale në Kosovë, të cilat ushtrohen nga Institucionet e Republikës së Kosovës; krijimin e një ambienti ligjor të përshtatshëm për mbrojtjen shëndetësore dhe sociale të qytetarëve të Kosovës, duke nxitur aplikimin e standardeve bashkëkohore; konceptimin e një strategjie të përgjithshme për mbrojtjen shëndetësore dhe sociale të qytetarëve të Kosovës; mbikëqyrjen e punës së Qeverisë në fushën e shëndetësisë dhe çështjeve sociale; integrimin e institucioneve shëndetësore në asociacionet ndërkombëtare të shëndetësisë;



### *Plani i Punës për vitin 2008*

Në përputhje me Strategjinë Legjislative të Qeverisë dhe objektivat, në muajin shkurt, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka hartuar dhe miratuar Planin e Punës për vitin 2008, në bazë të të cilit ka zhvilluar aktivitetet si komision funksional. Me qëllim të

vlerësimit të punës dhe planifikimit për pjesën e dytë të vitit 2008, gjatë muajit shtator, Komisioni ka ndryshuar dhe plotësuar Planin e Punës.

Plani i Punës për vitin 2008 ka paraparë: shqyrtimin e të gjitha projektligjeve që i përkasin fushave që mbulon Komisioni, zhvillimin e vizitave nëpër institucionet shëndetësore dhe sociale, vizita studimore jashtë vendit, monitorimin e zbatimit të ligjeve, organizimin e dëgjimeve publike, raportimin e ministrave përkatës dhe përfaqësuesve tjerë para Komisionit për çështjet që vlerëson të rëndësishme, bashkëpunim me të gjitha organizatat vendore e ndërkombëtare dhe ka paraparë të bashkëpunoj ngushtë me ministrinë përkatëse në hartimin e buxhetit për vitin 2008.

Në përgjithësi, duke marrë parasysh aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit, Komisioni ka arritur në masën më të madhe të përmbush Planin e Punës për vitin 2009.



## ***Mbledhjet e Komisionit***

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, gjatë vitit 2008, ka mbajtur 26 *mbledhje të rregullta*. Në këto mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar të gjitha projektligjet për të cilat është caktuar si komision funksional. Për të gjitha projektligjet, Komisioni ka përgatitur raporte me amendamente, të cilat i janë rekomanduar komisioneve kryesore për shqyrtim dhe miratim. Komisioni ka shqyrtuar edhe një numër të kërkesave drejtuar atij nga institucione të ndryshme për çështje të caktuara. Gjithashtu, Komisioni ka zhvilluar disa debate për çështjet që ka konsideruar që janë me rëndësi.



Gjatë vitit 2008, Komisioni ka formuar 7 *grupe punuese*, 6 grupe punuese për projektligje (për secilin projektligj nga një) dhe një grup punues për monitorim të zbatimit të ligjit. Numri i takimeve të grupeve punuese *gjithsej është 15*. Puna profesionale e grupeve punuese ka qenë shumë efikase, kjo ka ndikuar që Komisioni të jetë funksional dhe të paraqes rezultate të mira.

Me ftesë të Komisionit, në mbledhje kanë prezantuar përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve publike shëndetësore.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike dhe janë përcjell nga përfaqësues të organizatave jo qeveritare vendore e ndërkombëtare. Në mbledhjet e Komisionit janë zhvilluar debate të hapura dhe konstruktive. Në përgjithësi, mbledhjet e Komisionit kanë qenë të suksesshme dhe kanë plotësuar standardet demokratike.

### ***Shqyrtimi i Projektligjeve***

Gjatë vitit 2008 Komisioni për SHPMS ka shqyrtuar 6 *projektligje*. Projektligjet e shqyrtuara janë:

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit Punës;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë;
- Projektligji për Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin e Personave me aftësi të Kufizuara;
- Projektligji për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme;
- Projektligji i Punës;
- Projektligji për Ndërpërren e Shtatzënisë;



Katër projektligjet e para janë miratuar nga Kuvendi dhe janë në fuqi ndërsa, me kërkesë të Qeverisë është tërhequr Projektligji i Punës për ripunim. Ndërkaq, pas miratimit nga Kuvendi, Presidenti e ka kthyer për ndryshim Ligjin për Ndërprerjen e Shtatzënisë. Komisioni e ka rishqyrtuar dhe ka miratuar amendamentet e reja dhe tani ky projektligj është proceduar.

### ***Dëgjimet Publike***

Me qëllim të grumbullimit të sa më shumë informatave dhe përfaqësimit sa më të madh, duke përfshirë edhe grupet e interesit, Komisioni organizon dëgjime publike. Është me interes që në këto takime të përfshihen sa më shumë përfaqësues të grupeve që preken drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt nga ligji apo çështja për të cilën debatohet.

Komisioni për SHPMS, gjatë vitit 2008, ka mbajtur dy dëgjime publike. Dëgjimi i parë, për “Projektligjin e Punës”, është mbajtur në Kuvend në muajin qershor. Ndërsa, dëgjimi i dytë, me temën “Gjendja e Shëndetësisë në Regjionin e Gjilanit”, është mbajtur në Gjilan në muajin tetor, i cili është mbështetur nga NDI. Mbjatja e dëgjimeve publike jashtë ndërtesës së Kuvendit, nga Komisioni është vlerësuar si nevojë për të qenë sa më afër qytetarëve dhe problemeve të tyre. Gjithashtu, kjo paraqet një praktikë të re në punën e komisioneve.

### ***Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjeve***

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, neni 53, Komisioni ka autoritetin të mbikëqyr zbatimin e ligjeve nga Qeveria e Kosovës ose ministria përkatëse.

Në bazë të këtij autoriteti, në muajin korrik, Komisioni ka përzgjedhur të monitoroj zbatimin e Ligjit për Veprimtarinë Private në Shëndetësi, i cili



për këtë qëllim ka formuar një grup punues. Komisioni, i mbështetur nga stafi mbështetës dhe NDI, ka hartuar Planin e Monitorimit dhe Planin e Veprimit, në bazë të të cilëve, grupi punues ka zhvilluar aktivitetet e tij. Deri tani grupi punues ka mbajtur 6 takime.

Në kuadër të aktiviteve të monitorimit, Komisioni ka zhvilluar takime me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ka realizuar 10 vizita në terren, ku janë takuar me përfaqësues të institucioneve komunale (Prizren dhe Prishtinë) dhe përfaqësues të institucioneve private shëndetësore (Prizren, Fushë Kosovë dhe Prishtinë).

Deri tani grupi punues ka përgatitur një draft raport, i cili është shqyrtuar në Komision, me kërkesë të të cilit Komisioni ka vendosur të mbaj një dëgjim publik gjatë muajit janar 2009. Pas mbajtjes së këtij dëgjimi, Komisioni do të përgatisë një raport përfundimtar dhe do të kërkoj nga Kuvendi që ta shqyrtoj atë.



## Raportimi i Ministrave dhe përfaqësuesve tjerë

Gjatë vitit 2008, me kërkesë të Komisionit, ka raportuar Ministri i Shëndetësisë z. Alush Gashi, i cili raportoi mbi gjendjen e shëndetësisë në Kosovë dhe për përgatitjet e ministrisë në procedimin e Projektligjit për Sigurimet Shëndetësore. Para Komisionit kanë raportuar për gjendjen e shëndetësisë, Drejtori i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe Drejtori i Qendrës Emergjente.

Ndërkaq, me ftesë të Komisionit, për Projektligjin e Punës dhe Projektligjin e Inspektoratit të Punës, kanë prezantuar përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

### Vizitat në terren

Në kuadër të fushëveprimit të tij dhe funksionit të mbikëqyrjes së punës së institucioneve në fushën e shëndetësisë dhe çështjeve sociale, Komisioni për SHPMS ka zhvilluar dy vizita në terren.

Vizita e parë është zhvilluar në muajin maj në *Institutin Special të Shtimes*, ndërsa, vizita e dytë është realizuar në muajin tetor në *Spitalin Regjional të Gjilanit*.



Qëllimi i këtyre vizitave ka qenë njohja me gjendjen e këtyre institucioneve, problemet me të cilat ata përballen dhe ofrimi i përkrahjes brenda autoritetit që ka Komisioni.

### Vizita e Kryetarit të Komisionit homolog të Republikës së Shqipërisë

Komisioni për SHPMS i Kuvendit të Republikës së Kosovës e priti në një takim pune, Kryetarin i Komisionit për Shëndetësi dhe Çështje Sociale të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z. Tritan Shehu. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja me punën dhe mes anëtarëve të dy komisioneve si dhe vënia e bashkëpunimit në mes tyre.

Përfaqësuesit e dy komisioneve u pajtuan që në pranverën e 2009-ës të organizojnë një tryezë pune dy ose tre ditore në Shqipëri, ku do të vendosen bazat e bashkëpunimit me theks të veçantë, të hartohet një strategji e përbashkët e komisioneve për sfidat në shëndetësi dhe çështje sociale.

#### Statistika

- Mbledhje të komisionit	26
- Projektligje të shqyrtuara	6
- Grupe punuese të formuara	7
- Takime të grupeve punuese	15
- Monitorimi i ligjeve	1
- Vizita në terren	2 + 10
- Raportimi i ministrave	1
- Dëgjime publike	2

# KOMISIONI PËR SHËNDETËSI, PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE



Sadik Idriz (7+)  
Kryetar i Komisionit



Rita Hajzeraj (AKR)  
Zëvendëskryetare e Parë



Slobodan Petrovic (SLS)  
Zëvendëskryetar i Dytë



Teuta Hadri (PDK)  
Anëtare



Flora Brovina (PDK)  
Anëtare



Nurishahe Hulaj (LDK)  
Anëtare



Bujar Bukoshi (LDK)  
Anëtar



Armend Zemaj (LDK)  
Anëtar



Gjylnaze Sylaj (AAK)  
Anëtare



Qamile Morina (LDD)  
Anëtare



Mimoza Ahmetaj (PDK)  
Anëtare





## Kontaktet

### *Marrëdhëniet me Publikun*

Sherif Konjufca                      Shef i Seksionit

*Zyra N - 08, Kati për dhës*

038 211 186  
[sherif.konjufca@assembly-kosova.org](mailto:sherif.konjufca@assembly-kosova.org)

### *Stafi mbështetës i Komisionit*

Shpresa Haxhijaj                      Administratore e Zyrës

*Zyra E - 211, Kati II*

038 211 294  
[shpresa.ramosaj@assembly-kosova.org](mailto:shpresa.ramosaj@assembly-kosova.org)  
038 211 293  
[drita.morina@assembly-kosova.org](mailto:drita.morina@assembly-kosova.org)

Drita Morina                      Zyrtare e Lartë Ligjore

Fatime Qorri                      Zyrtare Ligjore

038 213 803  
[fatime.qorri@assembly-kosova.org](mailto:fatime.qorri@assembly-kosova.org)

Mirjeta Heta                      Nëpunëse Administrative

038 211 302  
[mirjeta.heta@assembly-kosova.org](mailto:mirjeta.heta@assembly-kosova.org)

### *Zyrtari nga NDI që mbështet Komisionin*

*Zyra N - 320, Kati III*

Shefki Kastrati                      Zyrtar Legjislativ

038 212 532    [shefkikastrati@gmail.com](mailto:shefkikastrati@gmail.com)  
044 513 651

### *Webfaqja e Kuvendit*

[www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org)

## Përkrahur nga:

